



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I PERSONELIT**

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR POZICIONIN DREJTOR NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PARASHKOLLORE
(KOPSHTI ME USHQIM “HASAN KOÇI”)**

Në mbështetje të pikës 1, shkronja “ç” dhe pika 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 8, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja “a” dhe “b”, nenit 64, shkronja “a”, të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në Urdhrin nr. 364 prot. 11528 datë 25.08.2026 “Për Ngritjen, Përbërjen dhe Detyrat e Komisionit të Vlerësimit për Zhvillimin e Procedurës së Emërimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parashkollor”, si dhe në Urdhrin nr.380 prot.11956 datë 09.09.2026 “Për shpallje konkurimi pozicioni Drejtor në Kopshtin me ushqim “Hasan Koçi”,

Drejtorja e Burimeve Njerëzore shpall konkurimin për pozicionin Drejtor në Kopshtin me ushqim “Hasan Koçi”, Bashkia Durrës.

I. Kriteret për aplikim

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pozicionin Drejtor i institucionit publik të arsimit parashkollor janë:

- Të kenë diplomë të studimeve universitare “Bachelor” që formon mësues të arsimit parashkollor.
- Të paktën, pesë vjet përvojë pune si mësues në arsimin parashkollor;
- Të jetë i trajnuar e pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar;
- Të mos bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike.

II. Dokumentacioni dhe mënyra e dorëzimit

- Cv-në dhe kërkesën për t’u pranuar në institucionin arsimor parashkollor.
- Të gjitha diplomat që disponon kandidati së bashku me listat e notave.
- Certifikatën e trajnimit për drejtues të institucionit arsimor parauniversitar.
- Tabelën e plotësuar me të dhënat për kandidatin (sipas modelit të përcaktuar nga komisioni).
- Dëshmi penaliteti (jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit).
- Dy rekomandime nga mësues, drejtues të institucionit arsimor ose titullarë të institucioneve, që kanë punuar gjatë viteve të fundit
- Vetëdeklarimin në lidhje me vërtetësinë e dokumenteve dhe informacionit të dhënë në procesin e aplikimit.

- h) Raport mjeko-ligjor.
- i) Dy rekomandime nga mësues, drejtorë të institucioneve arsimore ose titullarë të institucioneve që kanë punuar me kandidatin gjatë viteve të fundit.

Çdo kandidat, jo më vonë se 15 ditë pas shpalljes së njoftimit për drejtor të institucionit publik të arsimit parashkollor, duhet të dorëzojë pranë DBNJ të gjithë dokumentacionin e aplikimit të përcaktuar në pikën 2 si më sipër në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

III. Disa nga detyrat që do të kryejë Drejtori i Kopshtit janë:

1. Drejtori i IA-së është titullari i institucionit.
2. Drejtori, kur mungon përkohësisht, i delegon me shkrim një mësuesi të institucionit, të drejtat, duke saktësuar kompetencat e deleguara dhe afatin e delegimit, si dhe njofton NJVV për këtë delegim.
3. Drejtori ka përgjegjësinë për zbatimin në IA të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.
4. Drejtori ka përgjegjësi administrative dhe penale, në rastet e parashikuara nga ligji, për plotësimin, brenda afateve kohore, të dosjeve të fëmijëve dhe çdo dokumenti të nevojshëm për funksionimin e IA-së.
5. Drejtori ka përgjegjësi për krijimin në institucion të klimës së bashkëpunimit dhe të ndërveprimit ndërmjet punonjësve arsimorë në institucion.
6. Drejtori ka përgjegjësi për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet ministrisë dhe institucioneve/palëve të treta.
7. Drejtori merr masa për të siguruar kushtet për ndjekjen e IA-së nga fëmijët që i përkasin zonës së IA-së. Drejtori i IA-së bashkëpunon me NJVV-në e arsimit, me shërbimin psiko-social dhe me bordin e IA-it për të nxitur ndjekjen e IA-së nga fëmijët.
8. Drejtori ushtron çdo detyrë tjetër të parashikuar në këtë Rregullore dhe në kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.
9. Drejtori ka për detyrë të organizojë shpërndarjen e informacionit në dispozicion të qytetarëve, me të dhëna të mjaftueshme për cilësinë e shërbimit arsimor të IA-së.
10. Drejtori pas këshillimit me mësuesit:
 - a. vendos formimin dhe ndarjen e grupeve dhe merr miratimin e NJVV për këtë ndarje;
 - b. cakton ngarkesën mësimore të mësuesve;
 - c. përgatit çdo muaj listëprezencën e punonjësve të IA-së.
11. Drejtori shpall, në një vend të dukshëm për fëmijët dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre, orarin mujor të takimeve, të cilat kërkohen nga fëmijë ose persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre, si dhe kalendarin për takimet me ta.
12. Krijon një mjedis të sigurt, stimulues dhe të qëndrueshëm.
13. Krijon një mjedis marrëdhëniesh pozitive, bashkëpunuese dhe produktive me familjet dhe komunitetin, duke i bërë pjesëmarrës në vendimmarrje të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë e IA-it.
14. Përcakton udhëzime të qarta dhe të hollësishme për të përcaktuar masat parandaluese për emergjencat e mundshme.
15. Bashkëpunon me NJVV për sigurimin e materialeve didaktike dhe infrastrukturën fizike të nevojshme të godinës.

IV. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

- Afati për dorëzimin e dokumentave është **deri më datë 29.09.2026.**
- Kandidatët e kualifikuar sipas dokumentacionit të dorëzuar do të njoftohen në faqen zyrtare të Bashkisë dhe me postë elektronike **më datë 02.10.2026**
- Intervista me gojë do të zhvillohet më **datë 05.10.2026,** ora 11⁰⁰, në ambientet e Bashkisë Durrës.
- Klasifikimi përfundimtar referuar komisionit të vlerësimit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës më **datë 08.10.2026.**

Çdo kandidat, jo më vonë se 15 ditë pas shpalljes së njoftimit për drejtor të institucionit publik të arsimit parashkollor, duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të gjithë dokumentacionin e aplikimit të përcaktuar në pikën 2 si më sipër në origjinal ose të njësuar me origjinalin.